

VENDIM
Nr. 616, datë 29.7.2020

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË NGA AUTORITETI RRUGOR
SHQIPTAR TE BASHKIA TIRANË, TË SEGMENTEVE RRUGORE DYTËSORE,
KTHESA E KAMZËS–VORË (PARALELE DJATHTAS) DHE KTHESA E
KAMZËS–VORË (PARALELE MAJTAS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 7 e 8, të nenit 2, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar te Bashkia Tiranë, të segmenteve rrugore dytësore, kthesa e Kamzës–Vorë (paralele djathtas) dhe kthesa e Kamzës–Vorë (paralele majtas), deri brenda kufirit të Bashkisë Tiranë.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe